

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Roli i çdo qeverie është çdo ditë vendimtar për zhvillimin e vendit, edhe në kohë të mira, edhe në kohë normale, në kohë të zakonshme. Veçanërisht, në kohë të vështira roli i qeverisë është vërtet jetik, sepse vendimet e saj mund të sjellin kapërcim të krizave, por mund të shkaktojnë edhe thellim të tyre; mund të sjellin përmirësim, por mund të shkaktojnë edhe përkeqësim të jetës së qytetarëve. Fatkeqësisht, gjatë dy vjetëve të fundit ne jemi përballur me dy goditje natyrore, me tërmetin shkatërrimtar të 26 nëntorit dhe pandeminë globale të Covid-19. Por edhe në momentet më ekstreme, atëherë kur të gjithë thuajse u dorëzuam, kjo qeveri dha shpresë, dha optimizëm, u angazhua për të luftuar dhe ja ku jemi sot.

Çdo ditë qytetarët hyjnë në shtëpi të reja, nxënësit dhe mësuesit hyjnë në shkolla të rindërtuara, pacientët hyjnë në qendra shëndetësore cilësore, të gjitha sipas standardeve më të mira bashkëkohore. Por, fatkeqësisht, sot po përballemi përsëri me një krizë të re, me pasojat ekonomike dhe financiare të një lufte në mes të Europës në vitin 2022, në një kohë kur askush nuk e mendonte që mund të kërcënohej kaq seriozisht paqja dhe stabiliteti i një zone kaq të gjerë. Prandaj, nisur nga përgjegjësia e lartë që një qeveri duhet të ketë në përballimin e krizës, menjëherë pas fillimit të pasojave të rënda të luftës në Ukrainë, qeveria reagoi për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për të mbështetur veçanërisht shtresat në nevojë, që nga pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, familjet në ndihmë ekonomike e çdo kategori tjetër vulnerabël.

Konkretisht, me paketën e rezistencës sociale do të kemi indeksimin e menjëhershëm të pensionistëve që në pensionin e radhës për 673542 pensionistë. Gjithashtu, qeveria do të kompensojë rritjen e çmimit të produkteve të shportës me 3000 lekë të rinj në muaj për tre muaj rresht për 576000 qytetarë në nevojë. Natyrisht, këtu përfshihen pensionistët që marrin më pak se gjysma e pagës minimale, pensionistët që jetojnë vetëm, pensionistët invalidë, personat me aftësi të kufizuar dhe të gjitha familjet që janë të regjistruara në skemën e ndihmës ekonomike. Po ashtu, do të ketë mbështetje për fermerët me naftë pa taksa, si dhe qeveria do të ofrojë me dy muaj përpara hyrjen në fuqi të ligjit për pagën minimale, e cila që në muajin prill do të jetë 32 mijë lekë. Ama, në këtë situatë krize, qeveria nuk po mbështet vetëm shtresat në nevojë, por një masë më të gjerë qytetarësh.

Më lejoni këtu të them dy fjalë për mësuesit dhe të gjithë punonjësit e sistemit tonë arsimor, që, natyrisht, si shumë të tjerë e ndiejnë po ashtu krizën, edhe në çmimet e produkteve ushqimore, edhe në çmimin e karburantit, si dhe në çdo tregues tjetër. Të dashur mësues, Dua t'ju them se vëmendja e qeverisë ka qenë dhe do të jetë e veçantë edhe për ju. Vendimi për rritjen e pagave tuaja nuk ka qenë

vendim i rastësishëm, përkundrazi, ka qenë një shpërblim, ka qenë një vlerësim për punën dhe përkushtimin që ju tregoni çdo ditë në punën tuaj fisnike. Në mandatin e kaluar pagat tuaja u rritën me 32% dhe për këtë mandat jemi angazhuar që t'i rrisim me 40%. Kemi filluar ta mbajmë këtë premtim që në vitin e parë të mandatit, kur pagat në muajin korrik do të rriten për ju, ashtu sikurse për mjekët, për infermierët dhe për shumë kategori të tjera.

Të dashur mësues, si konsumatorë familjarë ju do të mbështeteni si shumë të tjerë nga vendimi për të mbajtur të palëvizur çmimin e energjisë elektrike në faturat e familjeve dhe të bizneseve të vogla. Po ashtu, qeveria do t'ju mbështesë ju dhe të gjithë shqiptarët që përdorin linja urbane qytetase dhe ndërqytetëse, duke paguar diferencën e çmimit të biletës, në mënyrë që asnjë udhëtar, askush prej jush, të mos preket nga ndryshimi i çmimit qoftë kur hipën në autobus brenda qytetit, qoftë kur hipën në një autobus për të shkuar nga njëri qytet në tjetrin. Po ashtu, nga muaji prill do të zerohet taksa mbi pagat deri në 40 mijë lekë, do të përgjysmohet taksa mbi pagat deri në 50 mijë lekë dhe do të ulet taksa mbi pagat nga 150 mijë lekë deri në 200 mijë lekë. Të dashur qytetarë, në dijeninë time, kolegët e opozitës në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat votuan kundër paketës për mbrojtjen e qytetarëve nga kriza dhe, me sa po dëgjoj edhe nga fjalimet e deritanishme, ata vazhdojnë ta kundërshtojnë atë.

Unë, të nderuar kolegë opozitarë, ju bëj thirrje ta shikoni edhe një herë qëndrimin tuaj deri në fund të kësaj seance dhe ta votoni paketën. Jo se na duhen votat tuaja si numra, aspak si numra, sepse numrat ne i kemi, ne kemi maxhorancën në këtë parlament, por vota juaj ka rëndësi, sepse, përtej të gjitha masave të marra nga qeveria, përtej çdo lloj pakete sociale, ka një mekanizëm që ndihmon shumë në përballimin e krizës, ndoshta më shumë se çfarëdolloj buxheti apo akti ligjor e nënligjor. Është solidariteti që duhet të tregojmë me njëri-tjetrin, është durimi; është toleranca; është bashkëpunimi dhe fryma konstruktive. Ndaj, mos u thoni qytetarëve që do ta kalojnë vetë krizën, sepse qeveria nuk i mbështet. Qeveria po e bën punën e saj, por, ju lutem, bëjeni edhe ju pjesën tuaj. Vetëm kështu, të gjithë së bashku, unë kam besimin që ne do t'ia dalim dhe, padyshim, do t'ia dalim siç ia kemi dalë edhe herë tjetër. Më e rëndësishmja është se ne nuk do të lëmë askënd vetëm. Faleminderit!